



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 shkurt 2022  
Nr.ref.:RK 1936/22

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI165/20**

Parashtrues

**Kurtesh Veliu**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit  
AC. nr. 1980/2020, të 24 qershorit 2020**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kurtesh Veliu (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Gjilan, i përfaqësuar nga Bardhosh Dalipi, avokat.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [AC. nr. 1980/2020] e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, të 24 qershorit 2020 (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 gusht 2020.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), me nenet 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 20 [Vendimet] dhe 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 23 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 2 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani (anëtarë).
8. Më 10 nëntor 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
9. Më 10 nëntor 2020, Gjykata i kërkoi informata Gjykatës Themelore në Gjilan për të konfirmuar datën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit nga parashtruesi i kërkesës.

10. Më 18 nëntor 2020, Gjykata Themelore në Gjilan informoi Gjykatën se Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës më 10 gusht 2020.
11. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1, të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KSH 165/20, emëroi gjyqtarin Radomir Laban si anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
13. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK 160/21 përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohej kryesuese e Kolegjeve shqyrtuese në rastet në të cilat ajo ishte caktuar anëtare e Kolegjit, përfshirë edhe rastin aktual.
14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4), të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1, të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 19 janar 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

16. Parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Komunën e Gjilanit deri në arritjen e moshës së pensionimit më 3 shtator 2015.
17. Më 3 maj 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Komunën e Gjilanit kërkesën për pagesën e tri pagave dhe të dy pagave (mujore) përcjellëse të pensionimit.
18. Më 5 shtator 2019, parashtruesi i kërkesës, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Gjilan, nëpërmjet të cilës, në emër të shpërblimit jubilar kërkoi pagesën e tri pagave dhe të dy pagave (mujore) përcjellëse të pensionimit, në shumën e përgjithshme prej 2.838,06 € me kamatë ligjore prej 8% (tetë përqind).
19. Më 22 janar 2020, Gjykata Themelore në Gjilan, me Aktgjykimin C. nr. 793/2019, refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës për shkak të parashkrimit të kërkesës, duke u thirrur në nenin 87 të Ligjit [Nr. 03/L-212] të Punës (në tekstin e mëtejme: Ligji i Punës).
20. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës, i pakënaqur me Aktgjykimin e lartcekur, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të

vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material. Po ashtu Komuna e Gjilanit, si e paditur në këtë çështje, kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material.

21. Më 24 qershor 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit AC. nr. 1980/2020, kishte refuzuar si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
22. Më 26 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës përmes Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit kërkoi të parashtrohet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, me pretendimet për shkelje të dispozitave ligjore.
23. Më 1 tetor 2020, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit KMLC. nr. 108/2020, e refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin: *“Pas shqyrtimit të propozimit tuaj dhe shkresave të lëndës, ju njoftojmë se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ju njofton se propozimi i juaj nuk është aprovuar, sepse në këtë çështje nuk ka bazë ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 247.1 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore”*.

#### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës dhe me nenet 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNj-së.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“Gjykatat e të dy instancave kanë konstatuar se kërkesëpadia e paditëses duhet të refuzohet si e pabazuar për shkak të kinse parashkrimit të kërkesës duke e pranuar pretendimin e përfaqësuesit të paditurës, ndërsa në lidhje me këtë pretendim (parashkrimin e kërkesës) në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 21.01.2020, si dhe në ankesën e paraqitur e kemi paraqitur arsyetimet tona përkitazi me këtë çështje se në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për parashkrimin e kërkesës për arsye se neni 87, i Ligjit të Punës, por edhe në tërësi ky ligj i rregullon të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës përderisa punëtori të jetë në marrëdhënie pune, ndërsa në këtë rast paditësi është pensionuar dhe realizimin e të drejtës e kërkon pas përfundimit të marrëdhënies së punës-pensionimit, duke u bazuar në kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar, respektivisht në nenin 36, paragrafi 9, nënparagrafi 9.3, të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, si dhe në nenin 36, paragrafi 10, të kësaj kontrate, e që kjo kontratë me asnjë dispozitë nuk e ka paraparë ndonjë afat të caktuar për realizimin e shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, por përkundrazi e obligon punëdhënësin e fundit që me rastin e pensionimit, pavarësisht të kërkesës se punëtorit të pensionuar, t'ia kompensoj shpërblimin jubilar dhe pagat*

*përcjellëse respektivisht që t'ia realizoj të drejtën që i takon, prandaj është e pajustificueshme, që në vend se të pësojë e paditura për mosveprim respektivisht moszbatimin e ligjit-Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, përkundrazi me aktgjykimet e gjykatave të të dy instancave pëson paditësi kinse për shkak të parashkrimit të kërkesës, duke ia refuzuar kërkesëpadinë gjegjësisht mosrealizimin e të drejtës subjektive që i takon”.*

26. Tutje parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë interpretuar gabimisht nenin 87 të Ligjit të punës sepse, sipas tij, afati për parashkrimin e kërkesës fillon të rrjedh nga dita e paraqitjes së kërkesës dhe jo nga dita e pensionimit dhe si rezultat i kësaj, kërkesa e tij ishte brenda afatit në kuptim të nenit 87 të Ligjit të punës.
27. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës i është lëshuar më 27 tetor 2016 nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa sipas tij, kërkesën për pagesën e këtyre pagave e ka paraqitur në Komunën e Gjilanit më 3 maj 2019, ndërsa padinë në gjykatë e ka paraqitur më 5 shtator 2020, që sipas tij bie brenda afatit të paraparë me nenin 87 të Ligjit të punës.
28. Përveç pretendimeve të mësipërme parashtruesi i kërkesës shton: *“Së këndejmi duke u nisur nga fakti se në lidhje me këtë çështje vlera e objektit të kontestit, respektivisht kërkesëpadia e paditësit ka qenë 2.838.06 € dhe në bazë të nenit 211.2, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, revizioni si mjet i jashtë zakonshëm juridik nuk është i lejuar në kontestet, po që se vlera e objektit të kontestit nuk i kalon 3.000 €, paditësi e ka shfrytëzuar mundësinë ligjore të paraparë me nenin 245, paragrafi 1, nënparagrafi b), nenin 246, si dhe nenin 247, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe përkitazi me këtë çështje iu ka drejtuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit në Prishtinë, me propozimin për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AC. nr. 1980/2020, të datës 24.06.2020 dhe aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i çështjeve Civile, C.nr.793/2019, të datës 22. 01.2020 për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale, ndërsa, nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, jemi njoftuar se pas shqyrtimit të propozimit të paraqitur dhe shkresave të lëndës, propozimi nuk është aprovuar, sepse pretendimet e cekura në propozim janë të pamjaftueshme për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë sipas nenit 247.1, pika b) Ligjit për Procedurën Kontestimore”.*
29. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon: *“I. TË PRANOHET kërkesa; II. TË KONSTATOHET se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenit 32 (E Drejta për Mjete Efektive Juridike); nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të drejtave]; nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]; nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenit 6 [E drejta për proces të rregullt]; dhe nenit 13 [E drejta për ankim efektiv] i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; III. TË SHPALLEN të pavlefshëm aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, në Prishtinë AC. nr. 1980/2020, i*

datës 24.06.2020, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiçan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i çështjeve Civile, C. nr. 793/2019, i datës 22.01.2020; IV. *TE KTHEHET* aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiçan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i çështjeve Civile, C. nr. 793/2019, i datës 22.01.2020 për rigjykim”.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

30. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

32. Gjykata më tej i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.*

33. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC. nr. 1980/2020] e Gjykatës së Apelit, të 24 qershorit 2020, të pranuar më 10 gusht 2020, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me ligj.
34. Megjithatë, përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënrrregullit (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

*“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

35. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”* (shih, rastet e GjEDNj-së, *Kemmachev kundër Francës*, Kërkesa nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, Kërkesa nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Kërkesa nr. 4241/03, kategoria (iii)).
36. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
37. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar shkel të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet 31, 32, 54, dhe 102 të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNj-së.
38. Në dritën e kësaj, Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit të kërkesës ka të bëjë: (i) me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material, sepse nuk është interpretuar drejtë dhe është zbatuar gabimisht neni 87 i Ligjit të punës me rastin e refuzimit të kërkesës së tij, si të parashkruar, dhe moszbatim të nenit 36, paragrafi 9 dhe 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar; (ii) pretendimin për mohimin e mjeteve juridike, si dhe (iii) pretendimet për shkelje të tjera të të drejtave kushtetuese.

*Përkitazi me pretendimet nën pikën (i) –mënyra e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material*

39. Gjykata fillimisht rikujton qëndrimin e saj të përgjithshëm se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike, si dhe interpretimet përkatëse të dispozitave ligjore a ligjit, si rregull hyjnë brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e standardeve dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë, dhe, rrjedhimisht, ajo nuk mund të veprojë si gjykatë *“e shkallës së katërt”* (shih, në lidhje me doktrinën e *“shkallës*

së katërt”, rastin e GjEDNj-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28).

40. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se interpretimi i së drejtës materiale dhe procedurale është detyrë parësore dhe bie brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë). Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të përcaktojë nëse efektet e interpretimit të tillë janë në përputhje me normativat dhe standardet kushtetuese.
41. Në këtë rast konkret, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit [AC. nr. 1980/2020] të Gjykatës së Apelit, si instancë përfundimtare në këtë çështje civile, dhe vëren se e njëjta ka shpjeguar në detaje arsyet e refuzimit të disa prej kërkesave të ngritura në kërkesëpadi nga parashtruesi i kërkesës, duke arsyetuar se: *“Pas vlerësimit të provave të administruara, gjykata gjeti se padia e paditësit duhet të refuzohet si e pabazuar me ligj për shkak të parashkrimit të kërkesës, konform nenit 87 të Ligjit të Punës. Në rastin konkret, paditësi padinë për shpërblimin jubilar dhe paga përcjellëse pas pensionimit e ka paraqitur me datën 05.09.2019, ndërsa të njëjtit marrëdhënia e punës në bazë të aktvendimit sipas fuqisë së ligjit i është ndërpre me date 03.09.2015, çka do të thotë se kërkesa është parashkruar”*.
42. Tutje, Gjykata vëren se përkitazi me këtë arsyetim/vlerësim të cilin parashtruesi e konteston, Gjykata e Apelit erdhi në këtë përfundim pasi kishte administruar provat siç ishin: vërtetimin [06-061-33928] e lëshuar nga Komuna e Gjilanit, Vendimin e 27 tetorit 2016 për njohjen e të drejtës së pensionimit, listën e pagave të 31 gushtit 2015 si dhe aktvendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
43. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se neni 87 [Afati i parashkrimit] i Ligjit të punës përcakton se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.
44. Prandaj, siç mund të vërehet nga arsyetimi i mësipërm, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit i ka adresuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke arsyetuar çështjen se përse në rastin e tij nuk mund të procedohej tutje si rezultat i parashkrimit të kërkesës duke aplikuar dispozita përkatëse të Ligjit të punës që ajo i kishte konsideruar si relevante përkitazi me rrethanat e rastit konkret.
45. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon *“moszbatim të nenit 36, paragrafi 9 dhe 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar”* pasi që, sipas tij, kjo e fundit nuk parasheh ndonjë afat të caktuar lidhur me paraqitjen e kërkesës për realizimin e shpërblimit jubilar dhe pagat përcjellëse. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se përcaktimi i afatshmërisë së padisë së parashtruesit të kërkesës, duke u bazuar në legjislacionin relevant në rastin konkret, respektivisht në Ligjin e punës është në pajtueshmëri me parimin e "hierarkisë së akteve juridike", sepse gjykatat respektive vlerësuan se çështja e parashkrimit të kërkesës së parashtruesit rregullohej me nenin 87 të Ligjit të punës.



46. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se ajo vet nuk mund të shndërrohet në gjykatë të faktit dhe t'u tregojë gjykatave të rregullta se cila do të ishte mënyra më e përshtatshme e zbatimit të së drejtës materiale, sepse një kompetencë e tillë, si rregull, i takon gjykatave të juridiksionit të rregullt që ta bëjnë. Gjykata thekson se ajo mund të ndërhyjë vetëm atëherë kur arsyetimi i vendimeve të gjykatave të rregullta është tejet arbitrar dhe i pajustificueshëm, çfarë në rrethanat konkrete nuk kemi të bëjmë me vendime qartazi arbitrare ose të pajustificuara.
47. Andaj, Gjykata nga shtjellimet e mësipërme konsideron se parashtuesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë gjykatave të rregullta, megjithatë pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GjEDNj-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat* kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
48. Në këtë kuptim, Gjykata, shikuar procedurën si tërësi, në kuptim të së drejtës për “gjykim të drejtë” këtë pretendim të parashtuesit të kërkesës e cilëson se i takon kategorisë së parë (i), pretendime “të shkallës së katërt”, andaj të njëjtin, Gjykata, si të tillë, në baza kushtetuese e deklaron qartazi të pabazuar dhe rrjedhimisht të papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

*Përkritazi me pretendimet nën pikën (ii) – mjetet juridike*

49. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës ka provuar të ushtrojë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, nëpërmjet Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, me arsyetimin se: *“nuk ka pasur mundësi që të paraqes kërkesë për revizionin, si mjet i jashtëzakonshëm juridik, në Gjykatën Supreme, mirëpo, ka shfrytëzuar mundësinë ligjore të paraparë me nenin 245, paragrafi 1, nënparagrafi b) të nenit 246, si dhe nenit 247 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, duke iu drejtuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, me propozim për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës të Apelit, AC. nr. 1980/2020, të 24 qershorit 2020 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, C. nr. 793/19, të 21 janarit 2020”*.
50. Gjykata vëren se Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, me njoftimin KMLC. nr. 108/2020, të 22 janarit 2020, e refuzon propozimin e parashtuesit të kërkesës me arsyetimin e se nuk kishte gjetur bazë të mjaftueshme ligjore për të ngritur një kërkesë të tillë në Gjykatën Supreme.
51. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën e GjEDNj-së, në shumë prej rasteve të saj, ka theksuar që mjeti juridik i cili nuk është në diskrecionin e drejtpërdrejt të parashtuesve të kërkesës për t'u ushtruar kundër një vendimi gjyqësor, nuk mund të konsiderohet mjet efektiv (shih, Gjykata Kushtetuese, në rastin KI215/19, parashtues: *Fekë Kuçi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 15 korrikut 2020, paragrafi 45, ku theksohet: *“... kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur pranë Prokurorit të Shtetit është një mjet juridik i cili nuk është në dispozicion të drejtpërdrejtë të parashtuesit të kërkesës, por*

varet nga "ndërmjetësi", e që në rastin specifik "ndërmjetësi" është Prokurori i Shtetit, dhe si e tillë nuk shqyrtohet nga Gjykata (shih, GjEDNj, rasti Tanase kundër Moldavisë, [VV], paragrafi 122).

52. Prandaj, në këto rrethana, Gjykata duke u mbështetur në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, konstaton se edhe ky pretendim i parashtruesit të kërkesës bie në kategorinë e tretë (iii), pretendime "të pambështetura apo të paarsyetuara", andaj Gjykata, si të tilla, në baza kushtetuese i deklaroi qartazi të pabazuara dhe rrjedhimisht të papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

*Përkritazi me pretendimet e tjera nën pikën (iii)*

53. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 22, 54 dhe 102 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore të GjEDNj-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii), pretendime "të pambështetura apo të paarsyetuara" kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:

a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih, në këtë drejtim, rasti i GjEDNj-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);

b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, 5 janar 2021, paragrafi 42).

54. Përkritazi me këto pretendime, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet përkatëse, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, parashtrues: *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 33; KI187/18 dhe KI11/19, parashtrues: *Muhamet Idrizi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafi 73, dhe së

fundmi rastin KI125/19 parashtrues: *Ismajl Bajgora*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63).

55. Prandaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me këto nene të Kushtetutës, konkludon se kërkesa duhet të deklarohet qartazi e pabazuar, sepse këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii), pretendime “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, sepse parashtruesi i kërkesës thjesht i përmend këto dispozita të Kushtetutës, pa shpjeguar se si janë shkelur ato.

### **Përfundim**

56. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet e sipërcekura të Kushtetutës dhe të KEDNj-së, janë qartazi të pabazuara, sepse të njëjtat cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë së parë (i) “gjykatë e shkallës katërt” dhe kategorisë së tretë (iii) pretendime “*të pambështetura ose të paarsyetuara*” në baza kushtetuese.
57. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa, në tërësinë e saj, duhet të deklarohet qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 19 janar 2022 , njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

  
Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Gresa Caka-Nimani